



Raporti i ndjekjes së Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore - qershor 2017

I GJYQËSORI

Pavarësia

Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit informoi se në veprimin për lëndën parahetimore të formuar në lidhje me **ngjarjet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill 2017**, ka filluar me thirrjen e qytetarëve për mbledhjen e informata të nevojshme.

Sipas PTHP-së, në periudhën e ardhshme ekipi i prokurorëve publikë i cili vepron mbi këtë lëndë do të thërrasë vazhdimisht persona që të mbledhë informacionet e nevojshme, kurse do të ndërmarrë edhe veprime të tjera për mbledhjen e informacioneve me shkrim, dëshmime dhe shqyrtimin e tyre.¹ **Delegacioni i Komisionit për respektimin e obligimeve dhe përpjekjeve të shteteve anëtare të ndërmarrë pas pranimit në Këshillin e Evropës më 01.06.2017** ka kryer takim me Zoran Karaxhovski – kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Republikës, ku është diskutuar mbi ngjarjet e fundit pas zgjedhjeve parlamentare dhe për implementimin e Rezolutës 1949 (2013) për dialogun postmonitorues me Republikën e Maqedonisë, si dhe përparimin në raport me bashkëpunimin e Këshillit të Evropës sipas rekomandimit 2022 (2013) me një reflektim të veçantë mbi sistemin juridik dhe prioritetet reformuese urgjente.

SPPMD nga Kavadarci në suazat e projektit “Rrjeta 23+” përpunuan analizë mbi zbatimin e Ligjit për matjen e llojit dhe madhësisë së dënimit².

Domethënë. analiza konstaton dobësi dhe mangësi për shkak të miratimit të shpejtë të Ligjit për matje të llojit dhe dënimit në aspektin e pavarësisë së gjykatës, parimit të garantuar kushtetues për ndarjen e pushtetit, bindjen e lirë gjyqësore dhe parimet për matjen e sanksioneve. Në këtë aspekt është vënë re: praktikë e pabarabartë e matjes gjyqësore të dënimit midis gjykatave të ndryshme; zbatim i dënimeve më të lehta për vepra penale më të rënda, kurse te veprat më të lehta penale politike më e ashpër

¹ <http://jorm.gov.mk/?p=4119>

² **Analiza e zbatimit të Ligjit për matjen e llojit dhe madhësinë e dënimit në gjykatat themelore Tetovë, Veles, Koçani dhe Kavadarci**, prof. dr. Gordan Llazhetiç-Buzharovska dhe prof. dr. Llazar Nanev





dënuese. Studimi nxjerr përfundimin se pasojat nga ky ligj janë më tepër në drejtim të **instrumentalizimit të drejtësisë për nevojat e politikës, sesa në barazimin e politikës dënuese**.³

Autorët e analizës propozojnë të shfuqizohet ky ligj, duke dhënë dy mënyra të mundshme. Mënyra e parë është nëpërmjet ndryshimit të nenit 39 paragrafi 3 të Kodit Penal duke u shfuqizuar kështu baza për zbatimin e këtij ligji. Mënyra e dytë është dorëzim i iniciativës te Gjykata Kushtetuese e RM-së duke theksuar kontradiktën e tij me nenin 8 të Kushtetutës (sundimi i të drejtës dhe ndarja e pushteti); mosharmonizimi me Kushtetutën e RM-së me nenin 98 sipas të cilit gjykatat janë të pavarura; dhe me nenin 101 në raport me obligimin e GJLRM si gjykata më e lartë që të sigurojë njehsim në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Raporti mbi punën e Këshillit Gjyqësor Buxhetor dhe mbi realizimin e buxhetit gjyqësor për vitin 2016 është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.⁴

Në raport është theksuar se buxheti i miratuar për vitin 2016 nuk ka qenë i mjaftueshëm për sigurimin e mjeteve të nevojshme për pushtetin gjyqësor, prandaj njësitë shfrytëzuese të pushtetit gjyqësor nuk kanë pasur mundësi të realizojnë një numër të caktuar obligimesh të cilat janë të garantuara me ligj. Në analizën e kryer nga Shoqata e Punëtorëve Financiarë – SHPF në suazat e projektit “Rrjeta 23+” është përpunuar detajisht problemi i financimit të pushtetit gjyqësor.⁵ Me Ligjin për buxhetin gjyqësor të miratuar në vitin 2003, është caktuar, se duke filluar nga 01.01.2004 mjetet për pushtetin gjyqësor duhet të jetë minimum 0,8% i prodhimit bruto vendor të RM-së. Duke marrë parasysh se ajo shumë në vitet buxhetore të veçanta nuk është miratuar, gjatë vitit 2010 janë kryer ndryshime dhe plotësime të ligjit për buxhetin gjyqësor, dispozitat e të cilit duhej të fillonin të zbatoheshin nga 1 janari i vitit 2011. Me këto ndryshime ligjore përcaktohet zmadhimi shkallë-shkallë i mjeteve të përcaktuara për pushtetin gjyqësor sipas viteve, të cilat në vitin 2015 duhej të arrinin shumën e përcaktuar ligjore prej 0,8% të PBV-së. Megjithatë, nga analizat e kryera mund të konstatohet se niveli i mjeteve të planifikuara/realizuara nuk e tejkalon 0,38% të PBV-së. Sipas Raportit të SHPF-së buxheti ideal gjyqësor do të ishte ai i cili do të jetë jo më pak se 0,5% e Buxhetit të RM-së.⁶

³ Kritikë për këtë ligj dhe nevojën për ndryshimin e tij e thekson edhe Komisioni për harmonizimin e politikës dënuese në raportin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016, dorëzuar në Kuvendin e RM-së.

⁴ http://www.vsrn.mk/wps/wcm/connect/ssrm/149e8bec-e8aa-4b66-a040-1fc68a8dd89c/Izvestaj+za+rabotata+na+SSRM+2015.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CR4-149e8bec-e8aa-4b66-a040-1fc68a8dd89c-kZvrQCW

⁵ http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/01238/mk/Analiza_ZFR.pdf

⁶ Raporti mbi gjendjet e përcaktuara, praktikat he rekomandimet për financim më të mirë të gjykatave në RM – analiza e dytë, *Shoqata e Punëtorëve Financiarë*, Veles, mars 2017





Paanësia

U.d. kryetari i Gjykatës Penale Stojaçe Ribarev vendosi për **tërheqjen e gjykatëse Bahçovanovska nga lëndët “Trust” dhe “Total”** për të cilat duhet të jepet vlerësim për aktin akuzues të PSP-së, me kërkesë të saj. Shkaqet për tërheqjen nuk janë të njohura nga publiku përveç faktit se gjykatësja Bahçovanovska është bashkëshortja e Vlladimir Bahçovanovskit, funksionar i lartë në VMRO-DPMNE dhe drejtori i Lotarisë Shtetërore. Në vend të Bahçovanovskës, vlerësim mbi akuzën për lëndën “Trust” do të japë gjykatësi Marjan Grubisha, kurse për “Total” gjykatësi Dragan Nikollovski.⁷

Përgjegjësia

Qeveria miratoi propozim për shkarkimin e prokurorit publik të RM-së Marko Zvrlevskin

Si shkaqe të vendosura në arsyetim shkruan se “Propozimi për shkarkimin e Marko Zvrlevskit nga funksioni i prokurorit publik i Republikës së Maqedonisë, para përfundimit të mandatit, është ushtrimi joligjor, jo në kohë dhe joprofesional sa duhet i funksionit. Gjithashtu, në sjelljen dhe veprimin e vet i emëruari ka dëshmuar se nuk është i aftë për zbatimin e funksionit, për shkak të mosdorëzimit të kërkesës për ngritjen e procedurës penale për rastet e parapara me ligj dhe për shkak të prishjes të reputacionit të funksionit”.⁸

Këshilli i prokurorëve publikë me shumicë votash (8 përkundrejt 1) e ka pranuar propozimin e qeverisë për shkarkimin e prokurorit shtetëror publik, Marko Zvrlevski. Pas dy orësh diskutim, kryetari i Këshillit, Petar Anevski e ka shpallur vendimin, por refuzoi të arsyetojë shkaqet.⁹ Deri në zgjedhjen e prokurorit të ri, funksionin do ta kryejë Xhelal Bajrami, si u.d. Prokuror publik shtetëror.

Profesionalizimi, ekspertiza

Më 12.06.2017, **Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë ka mbajtur takim pune me ekspertë francezë**, ku janë shkëmbyer mendime dhe përvoja në lidhje me Ligjin për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, si dhe për mundësinë të zbatohen përvojat e Shkollës Nacionale për Magjistrantë në Republikën e Francës.

II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Komisioni Shtetëror për Ndalimin e Korrupsionit

⁷ <http://www.mkd.mk/makedonija/sudijkata-bahchovanska-nema-da-gi-ocenuva-obvinenijata-za-trust-i-total>

⁸ <http://sobranie.mk/downloaddocument.aspx?id=1cf11842-ce21-4ea4-ab3f-108ec70c7989&t=pdf>

⁹ http://www.24vesti.mk/sovetot-na-javni-obviniteli-go-prifati-predlogot-za-razreshvanje-na-zvrlevski?quicktabs_popularna_sodrzina=2





Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Bashkësive e shqyrtoi Raportin vjetor mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2016 në 4 seanca gjithsej gjatë qershorit. Kritika për punën e KSHPK-së si nga parlamentarët ashtu edhe nga përfaqësuesit e organizatave qytetarë të cilat kanë marrë pjesë në seancë.

Platforma e organizatave qytetarë për luftë kundër korrupsionit i bëri thirrje Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Bashkësive të miratojë Përfundim me të cilin Kuvendit do t'i propozojë të mos e miratojë Raportin vjetor mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK) në vitin 2010.¹⁰

Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit konsideron se edhe pse me strukturën e vet Raporti vjetor i jep përgjigje zbatimit të kompetencave të KSHPK-së, ai nuk jep pamje gjithëpërfshirëse mbi aktivitetet të cilat janë ndërmarrë dhe nuk janë ndërmarrë në vitin 2016, kurse në përputhje me kompetencat e dhëna në Ligjin për Ndalim të Korrupsionit, Ligjit për Pengim të përplasjes së interesave, Ligjit për mbështetje të informatorëve dhe Kodin Penal.

Një prej vërejtjeve kryesore që e tangon drejtpërdrejt sektorin qytetar është fakti se në Raportin vjetor nuk është prezantuar lënda ku KSHPK-ja kërkon veprim kompetent nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për të Hyrat Publike (DHP) dhe Drejtoria për Zbulim Financiar kundër 21 shoqatave dhe fondacioneve dhe një partie politike.

Procedurat për lëndët e Prokurorisë Speciale Publike

SPS-ja ngriti akuza një ditë para përfundimit të afatit dhe kërkoi paraburgim për politikanë udhëheqës. Prokuroria Speciale Publike ka ngritur akuza kundër 97 personave fizikë dhe 7 personave juridikë për një sërë veprash penale të zbuluara në bisedat e përgjuara. Gjithsej janë dorëzuar 17 aktakuza dhe, duke pasur parasysh se tri raste tashmë procedohen prej më parë, numri i përgjithshëm i akuzave të ngritura është 20.¹¹

Prej hetimeve të paralajmëruara deri më tani nuk është ngritur akuzë për rastet "Tair" dhe "Tablla", kurse "Target" dhe "Kështjella" janë bashkuar në një. Janeva tha se për rastin e parë nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të përfundohej hetimi sepse financimi jolegal tetëvjeçar i partisë nuk mund të hetohej për një muaj. Në lidhje me rastin "Tablla", prokuroria theksoi se ai po punohet edhe mandej dhe

¹⁰ http://www.soros.org.mk/CMS/Files/Documents/Dopis_do_Sobranieto_Platoforma.pdf

¹¹ <http://www.jonsk.mk/2017/06/29/%D0%B8%D0%B7%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B0-%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%BF%D0%B5%D1%86/>





është zgjeruar edhe me persona të tjerë – funksionarë të lartë. Janeva theksoi se “tani për tani” nuk ka akuzë për funksionarë të lartë të BDI-së në pushtet.¹²

Nuk ka pajtueshmëri politike për vazhdimin e afatit të Prokurorisë Speciale Publike për dorëzimin e akuzave, për shkak të kundërshtimit të VMRO-DPMNE-së. Prokuroria Speciale Publike deklaroi se do të vazhdojë me hetimet, sepse koha e veprimit sipas ligjit është 5 vjet. PSP-së i kanë mbetur 55 për qind biseda pa i dëgjuar, kurse ato të dëgjuarat nuk janë analizuar të gjitha.¹³

Në raport me ndërmarrjen e kompetencës për rastin “Monstrum” prokurorja Janeva e akuzoi Këshillin e Prokurorëve Publikë për “mosbashkëpunim” prandaj nuk kishte mundësi të kryejë mbikëqyrje në këtë lëndë dhe të përcaktojë a është PSP-ja është kompetente për të.¹⁴

Lëndët me titullin “**Total**”, “**Trevnik**”, “**Tifani**”, “**Titanik**” dhe “**Tortura**” nëpërmjet shpërndarjes automatike i janë dhënë në punim për vlerësim të aktakuzës gjykatëses Monika Bahçovanovskës.¹⁵

Lëndët të cilat janë në kompetencë të Njësisë për Krim të Organizuar, gjithashtu, nëpërmjet shpërndarjes automatike u janë caktuar gjykatësve:

- Gjykatëses Lidija Petrovska, lënda “**Tarifa**”, gjykatësit Goran Boshevski lëndët “**Trezor**” dhe “**Tenk**”, gjykatëses Verka Petkovska lënda “**Titanik-2**”, gjykatëses Lenka Davitkovska lëndën “**Toplik**”, gjykatësit Ivica Stefanovski lëndën “**Tenderë**” dhe gjykatëses Tatjana Mihajlova lëndët “**TNT**” dhe “**Traektorja**”.

Në publik janë shprehur dyshime në lidhje me “rastësinë” e shpërndarjes së lëndëve nëpërmjet sistemit AKMIS.

¹² <http://rsm.mk/web/%D0%BD%D0%B5%D0%BC%D0%B0-%D0%BD%D0%B8%D1%82%D1%83-%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B8%D0%B2-%D0%B4%D1%83%D0%B8/>

¹³ <http://www.jonsk.mk/2017/06/29/%D0%B8%D0%B7%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B0-%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%BF%D0%B5%D1%86/>

¹⁴ <http://meta.mk/sjo-podnese-17-obvinenija-talir-ke-pocheka/>

¹⁵ <http://bit.ly/2tQLoKX>





Gjykata Themelore Shkup 1 e ka miratuar aktakuzën e SPS-së për lëndën “Transporter” e cila mbahet 21 persona, kurse i akuzuari i parë është kryetari i komunës Manastir, Vlladimir Taleski. Lënda i është shpërndarë gjykatës Lidija Petrovska.¹⁶

Apelacioni i Shkupit e pranoi ankesën e PSP-së për vendimin për garanci, në vend paraburgim të biznesmenit Sead Koçan dhe e ktheu lëndën për rivendim në Gjykatën Penale – Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup.¹⁷ Gjykata ka vlerësuar se në dobi të garancisë së dhënë nuk janë dorëzuar të gjitha dëshmitë relevante për vendimmarrje të ligjshme për propozimin prej të cilit do të përcaktohej baza e garancisë së dhënë. Koçan është i dyshuari i parë për rastin “Trust” për falsifikim të dokumentacionit të tenderit për tenderin e ELEM-it në vlerë prej 17 milionë eurosh. I dyshuari dy muaj ka qenë në ikje ças Këshilli Penal i Gjykatës Penale i ka caktuar paraburgim.

PSP-ja ka dorëzuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë te Gjykata e Lartë për lëndën “Talir”, e cila lidhet me financimin e partisë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE.¹⁸ Me të kërkohet që Gjykata e Lartë ta përcaktojë paligjshmërinë e vendimit të Këshillit Penal të Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup, me të cilin është refuzuar kërkesa për sigurim të një pjese të pronës së partisë VMRO-DPMNE. Nga PSP-ja theksojnë se me BZZ është dëshmuar domosdoshmëria e interpretimit të Ligjit për Financim të partive politike në përputhje me standardet ndërkombëtare në bazë të të cilave ky ligj është miratuar, si dhe të rrethanës se interpretimi restriktiv i gjykatës së shkallës së parë të ligjit të përmendur është në

¹⁶ http://sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/81fa6b31-2093-4bad-b34c-09de584d39de/!ut/p/z1/rVLLbslwEPwWDjkGbOggpicX8SgFoRYoxBeUh_OAxAGJSUq_vkY9VEItUFFfLfszszuziyhal8rdKolcmQjupurt0M6mM7QswM8wwfPXRyB9sPGiSwD6NIpdAgwHgOhl_huiiPpc5jJGTn7w0sTfZDsNyKogQS58JrmrQcV KmWiAjdDteKaht6Br6pbnBrpnWr4O3YC1sRWY6j7p5X4SIocm9OqawVP_8MshoPjOGmSMaJQK7ytNwjOTR4gWLGQFK5qHQn3HUuYPGmhQ13VTIOVO5FtmNE85_MSJRSnR-hyLHGXF_rYyGw1slMu-0Sb4pTUjalZVwmq05KLIVDPzPyY1gvMKZ2GN23dWuCG_f-rckT--tosq6mS731OiNIJwyd5VYv-ykkq4VUx7UzXD3JWxnvBQoPVN1DxbZtg86vxjwla6M67qehFmPQ8fzTQijcYndWLN2w!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urilc=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F81fa6b31-2093-4bad-b34c-09de584d39de

¹⁷ http://www.vsrn.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti/b70351a2-c91b-4bd2-87c9-cbde21c2bece/!ut/p/z1/rVJNU8lwEP0tHnos2bZAI7fi8GGFYRQqmgvTpKgttklpAxV_vWE8ODIKOJbZt57u-tloKWilhwI8ahSqUIM10HpL1qD5pN8B5g5E2f7gD3wPVMHQzQc9HiFGDQB0RO858RQYQJVagEbcWWZilb5a8GVNVlgElyrkRowI5XkjWAuuC0rNA2WceiZpNGtum5rGMMyGnHbYjbljB_0CpZGKlgLvThn8DA_PlwaD45B_ERiTNJP9PEgipejEj17zkZWNb6u9EqaK6NcCAuq4bsZRxxhtM5gb8RElkpdDyOxIF2of75WMy7LuA5z2rhh1He4L1onYpr9FcyDLXkOz_GNMQjiscJeW3ruxwUn56375S3j93iDro9GWzIVifoxSKv-mM_-UetbBdjrtjvcEiVImZirVEy4uoRT7PPWdvivcRX5iBv6vr2TrvUm_vZDG-ufkAHv9YIA!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urilc=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fb70351a2-c91b-4bd2-87c9-cbde21c2bece

¹⁸ <http://www.jonsk.mk/2017/06/16/%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%B5%D1%81%D0%B5%D0%BD%D0%BE-%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8/>





kundërshtim edhe me përpjekjet për parandalimin e korrupsionit si kusht i domosdoshëm për ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe respektimin e parimit të sundimit të së drejtës.

BZZ e tretë e dorëzuar – që lidhet me të dënuarin e vetëm në rasti “Puç”, Zvonko Kostovski, nuk është vendosur ende në rend ditor sepse lënda gjendet në Këshillin për Prokurorë Publikë dhe nuk janë dorëzuar të gjitha listat në lidhje me këtë lëndë të Gjykata e Lartë.

III TË DREJTAT THEMELORE

Liria e shprehjes dhe pluralizmi në mediat

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-Vizuale (ASHAAV) vazhdoi me përgatitjen e Strategjisë për punën e ASHAAV-it dhe nëpërmjet kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese mbi radiodifuzerët. Gjatë qershorit është kryer mbikëqyrje kontrolluese mbi 15 radiodifuzerë, me qëllim të monitorimit të zbatimit të obligimeve të përcaktuara në lejen për emitim në radio edhe TV, si dhe zbatimin e konceptit programor. “Me mbikëqyrjen kontrolluese të kryer është konstatuar se të gjithë radiodifuzerët e lartpërmendur kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore.”¹⁹

Agjencia ka reaguar edhe në lidhje me sulmin e ekipit të TV “24 Vesti” në Shtip, gjatë përgatitjes së materialit për mbindërtimin e dyshimtë të Qendrës tregtare në Shtip të cilën e ndjekin vazhdimisht kontroverse.²⁰ Me gjykim dhe rikujtim të sulmeve të mëparshme mbi punëtorët në media, Agjencia theksoi se “siguria e profesionalistëve të mediave në asnjë rast nuk duhet të rrezikohet.” Agjencia, ka apeluar përsëri që të mundësohet veprimtaria e mediave dhe punëtorëve të mediave duke pasur kujdes për kushtet në të cilat i kryejnë me dinjitet obligimet e veta profesionale.

Lufta kundër diskriminimit

Avokati i popullit ka dorëzuar iniciativë te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për ndryshim të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim të ndryshimit të zgjidhjes ligjore m të cilën bëhet diskriminim në bazë të seksit dhe trajtimit të pabarabartë të prindërve – në rastet kur nëna nuk i përmbush kushtet për kompensim për fëmijë të tretë, këtë të drejtë mund ta realizojë babai si prindi tjetër.”²¹

Më 19.05.2017, duke vepruar sipas parashtresës së Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi miratoi mendim me të cilin

¹⁹ http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3295%3A-15-&catid=103%3Astarti-info-srd-srd&lang=mk

²⁰ <http://24vesti.mk/napadnata-ekipata-na-tv-24-vo-shtip>

²¹ <http://sdk.mk/index.php/makedonija/tatkovtsite-se-diskriminirani-oti-nemaat-pravo-na-pari-za-treto-dete-predupredi-narodnot-pravobranitel/>





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



vërtetohet diskriminimi i shumëfishtë i drejtpërdrejtë. Bëhet fjalë për shpallje për punësim e botuar nga hoteli “Glam” në Shkup, ku kërkohet “person femër në moshë nga 30-45 për punë në kuzhinë – shërbim i mëngjesit”. Me shpalljen e tillë nuk mundësohet qasje e barabartë te vendi i punës për burra, duke u bërë kështu diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të seksit, por në të njëjtën kohë mundësohet qasje te ky vend pune vetëm për gratë më të reja se 30 vjet dhe më të vjetra se 45 vjet, duke u shkaktuar kështu diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të moshës.”²²

²² <http://mhc.org.mk/announcements/594#.WVxBNhWGNdh>



Projekti Rrjeti 23+ është i finansuar nga Bashkimi Europian. Qendrimet e shprehura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe jo çdo herë i reflektojnë mendimet e donatorit.

